

N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail. contact@pallatirinise.com

www. pallatirinise.com

Nr. 4/333 Dt. 24.02.2026

Në bazë të nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë Tregtare si dhe në bazë të Statutit të Ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., në mbledhjen e mbajtur me datë 24.02.2026 miraton këtë,

RREGULLORE
PËR PROCEDURËN E DHËNIES ME QIRA TË HAPËSIRAVE TË N.P.L
“PALLATI I RINISË” SH.A.

Neni 1

Dhënia me qera e hapësirave të N.P.L “Pallati i Rinisë” Sha.A.

1.1 Me këtë rregullore përcaktohet procedura e dhënies me qira të të gjitha hapësirave të destinuar për qiradhënie sipas shtojces 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Mënyra e qiradhënies

2.1 N.P.L. “Pallati i Rinisë” sh.a. lejon shfrytëzimin e të gjitha hapësirave të destinuar për qiradhënie sipas kohëzgjatjes:

- 2.1.1 Për orë,
- 2.1.2 Për ditë,
- 2.1.3 Për javë,
- 2.1.4 Për muaj,
- 2.1.5 Për vit.

2.2 Lejimi i shfrytëzimit të të gjitha hapësirave sipas paragrafit 2.1 të kësaj rregulloreje bëhet përmes kontratës së nënshkruar nga të dyja palët kontraktuale.



Neni 3

Format e kërkesave për qiramarrje

3.1 Të gjithëpersonat fizik dhe subjektet juridike të cilat janë të interesuara për shfrytëzimin e hapësirave sipas kohëzgjatjeve të cekura në nenin 2, paragrafi 2.1, duhet t'i drejtohen N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.A.

Neni 4

Mënyra e dhënies me qira

4.1 N.P.L "Pallati i Rinisë" ofron hapësirat për shfrytëzim në këto mënyra:

4.1.1 Në bazë të kërkesës së palës dhe

4.1.2 Ofertës Publike për shfrytëzim/ankand publik.

4.2 Kërkesat sipas paragrafit 4.1.1 mund të dërgohen edhe në formë elektronike në emailin zyrtar N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.A.

4.2.1 Kërkesat e parashtruara në formë fizike dërgohen për shqyrtim tek Zyra për Marrëdhënie me Klient, Marketing dhe promocion dhe zyra për Kulturë dhe Sport.

4.3 Ofertat sipas paragrafit 4.1.2 dorëzohen në arkivë dhe të njejtat përcillen tek Komisioni përkatës për vlerësim të mëtejshëm.

Neni 5

Mënyra e aplikimit në bazë të kërkesës

5.1 Kërkesat e parashtruara në bazë të paragrafit 4.1.1. duhet të përmbajnë:

- Formulari i aplikimit i cili mund të shkarkohet përmes ueb faqes/emailit zyrtar.
- Kopjen e një dokumenti identifikues të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit (për biznese) me informatë përcjellëse.
- Hapësira që kërkohet dhe afati kohor për shfrytëzim.

5.2 Zyra për Kulturë dhe Sport i shqyrton kërkesat për mbajtjen e aktiviteteve sipas renditjes së aplikimit dhe kalendarit për hapësirat e lira.

5.3 Pas aprovimit të kërkesës, i gjithë dokumentacioni dërgohet në Zyrën Ligjore për hartimin e kontratës së qirasë.

Neni 6

Mënyra e aplikimit në bazë të ofertës

6.1 Aplikimi në bazë të ofertës duhet të përmbajë:

- Formulari i aplikimit i cili mund të shkarkohet përmes ueb faqes/emailit zyrtar.
- Kopjen e çertifikatës së regjistrimit të biznesit me informatë përcjellëse.
- Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të autorizuar të biznesit.
- Çmimin e ofertuar për m² i cili duhet të jetë pa TVSH;
- Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmohet se biznesi është aktiv;
- Të dhënat e Arkës fiskale, të cilat duhet të përputhen me çertifikatën e biznesit.
- Dëshminë e pagesës për aplikim, në vlerë prej 300€, e cila paguhet në xhirollogarinë e Pallatit.
- Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur sipas shpalljes publike për ofertim.
- Në pjesën e jashtme të zarfit, duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr. i hapësirës, dhe kontaktet e ofertuesit (email dhe/apo nr. i telefonit).

6.2 Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

- 6.2.1 Ofertuesi i cili si ish-qiramarrës nuk i është përmbajtur kontratës;
- 6.2.2 Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara sipas paragrafit 6.1;
- 6.2.3 Nëse oferta arrinë pas skadimit të afatit për dorëzim të përcaktuar në shpallje.

6.3 Tarifa e aplikimit sipas pikës 7 të paragrafit 6.1.

- 6.3.1 Do të kompenzohet me faturën e parë të qirasë.
- 6.3.2 Ofertuesi i cili tërhiqet nga ankandi/kontrata e qirasë, nuk do t'i kompenzohet tarifa;
- 6.3.3 Ofertuesit të zgjedhur i cili lidhë kontratë të qirasë, depoziti do t'i kthehet në momentin e përfundimit të afatit të kontratës.

Neni 7

Shpallja publike për ofertim

7.1 Shpallja publike për oferta (sipas shtojcës 2 të kësaj Rregulloreje) duhet të përmbajë:

- 7.1.1. Formularene aplikimit;
- 7.1.2. Hapësirën e lirëtë destinuar për qiradhënie, duke përfshirë sipërfaqen dhe cmimin për m²;
- 7.1.3. Identifikimi vizual i hapësirës;
- 7.1.4. Afatin e kohëzgjatjes së kontratës për qiradhënie;
- 7.1.5. Afatin e kohëzgjatjes së shpalljes publike, shtatë (7) ditë pune nga dita e publikimit;
- 7.1.6. Vendin e dorëzimit të dokumentacionit;
- 7.1.7. Mundësinë që pjësemarrësit e interesuar përkatësisht ofertuesit të mund të shikojnë hapësirat sipas shpalljes publike brenda afatit të caktuar;

7.2. Shpallja publike për ofertapërgatitet në gjuhët zyrtare, ku e njëjta publikohet në media online, në ueb faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të Ndërmarrjes.

7.3. Afati i përgatitjes së dokumentacionit për dorëzimin e ofertës do të jetë shtatë (7) ditë nga dita e publikimit, dorëzimi i këtij dokumentacioni bëhet në ditën e hapjes së ofertave.

Neni 8

Komisioni për hapjen dhe vlerësimin e ofertave

8.1 Komisioni për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, do të formohet nga Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L. "PALLATI I RINISË" SH.A. në Prishtinë.

8.2 Komisioni për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, do të ketë në përbërje tre (3) anëtarë nga departamentet përkatëse.

Neni 9

Hapja e ankandit

9.1. Komisioni vlerësues pas shpalljes publike zbaton procedurën e ankandit si në vijim:

9.1.1 Hapja e zarfave nga Komisioni vlerësues do të bëhet në datën, orën dhe vendin e caktuar, të njoftuar që në fillim të procedurës së ankandit. Në seancën e hapjes së zarfave, duhet të jenë prezent së paku tre anëtarë të këtij komisioni.

9.1.2 Ofertuesit të cilët i plotësojnë kriteret para komisionit i ofrojnë çmimet tyre në zarf të mbyllur dhe komisioni i hap të njëjtat para ofertuesve.

9.1.3 Oferta llogaritet e vlefshme pasi që ofertuesi t'i ketë paguar apo depozituar më parë vlerën prej 300€ si tarifë e aplikimit. Paraprakisht kjo vlerë duhet të paguhet në xhirollogarinë e institucionit para mbajtjes së ankandit.

9.1.4 Tatimi mbi vlerën e shtuar nuk përfshihet në ofertë. Blerësi do ta paguaj çmimin e ofertës plus TVSH-në.

9.1.5 Personi juridik ose përfaqësuesi i autorizuar i tij me rastin e paraqitjes së ofertave në ankand duhet të ketë të bashkangjitur edhe dokumentin identifikues dhe autorizimin.

Neni 10

Shpallja e fituesit

10.1. Komisioni vlerësues, pas marrjes së vendimit për shpalljen e fituesit, i njofton pjesëmarrësit në ankand për ofertën fituese, njëherit njofton me shkrim fituesin për formën dhe kohën e pagesës e cila duhet të bëhet në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e shpalljes së fituesit të ankandit.

10.2. Nëse fituesi i ankandit tërhiqet, atëherë të drejtën e marrjes së hapësirës me qira e ka ofertuesi i dytë me radhë që ka çmimin më të lartë.

- 10.3.Nëse asnjëri nga ofertuesit nuk i plotësojnë kriteret e ankandit, atëherë Komisioni vlerësues anulon ankandin.
- 10.4.Komisioni vlerësues harton procesverbalin (sipas shtojcës 3 të kësaj Rregulloreje) për secilin ankand publik dhe ia bashkangjet atë Raportit përfundimtar të cilin ia dorëzon Kryeshefit Ekzekutiv.
- 10.5.Pjesëmarrësi i cili ofron çmimin më të lartë nga çmimi fillestar i përcaktuar në ankand, do të shpallet fitues i cili më pas duhet të lidh kontratën e qirasë.
- 10.6.Për lidhjen e kontratës, fituesi duhet të sjellë:
- 10.6.1. Dokumentin identifikues;
- 10.6.2. Një kopje të ofertës fituese.

Neni 11

Ankesat

- 11.1.Pjesëmarrësit të cilët konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat gjatë mbajtjes së ankandit, kanë të drejtë ankesë në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në afat prej 3 (tre) dite nga dita e mbajtjes së ankandit.
- 11.2.Komisioni për shqyrtimin e ankesave vendos lidhur me ankesën në afat prej 3 (tre) ditësh pas pranimit të saj.
- 11.3.Ankesa pezullon vendimin e komisionit deri në përgjigjen e ankesës.
- 11.4.Në rast se komisioni refuzon ankesën, atëherë pala e pakënaqur mund të iniciojë padi në gjykatën kompetente, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimi

Neni 12

Identifikimi i hapësirave të lira

- 12.1Identifikimi i hapësirave të lira për qiradhënie, bëhet duke u bazuar:
- 12.1.1 Në hapësirat e lira të cilat janë pa kontrata të qirasë.
- 12.2Hapësirat e lira identifikohen nga Zyra për Marrëdhënie me klient, marketing dhe promocion dhe përgatiten brenda 3 (tre) ditësh për shpallje publike për oferta.

Neni 13

Kontrata e qirasë

- 13.1Kontrata e qirasë duhet të përmbajë:
- 13.1.1 Të dhënat e palëve (Emërtimi i plotëi qiradhënësit dhe qiramarrësit, numri personal/NUI nëse është biznes, adresa, përfaqesuesi ligjor nëse është person juridik)
- 13.1.2 Objekti i kontratës:Përshkrimi i saktë i hapësirës, Adresa ku ndodhet me sipërfaqe në m2 dhe numri i lokalit.

- 13.1.3 Qëllimi i përdorimit të hapësirës (aktivitet afarist, event etj)
- 13.1.4 Kohëzgjatja e kontratës: Afati i kontratës për shfrytëzim orë/ditë të specifikohet data dhe ora e fillimit dhe përfundimit
- 13.1.5 Mënyra e pagesës: Shuma mujor/ditore/orë, afati i pagesës, shpenzimet e përbashkëta, TVSH, penalitetet për vonesë, tatimi 9%.
- 13.1.6 Depozita/Garancia: Shuma e depozitës dhe Kushtet e kthimit
- 13.1.7 Të drejtat dhe detyrimet: Qiradhënësi dorëzon hapësirën në gjendje të rregulltë.
- 13.1.8 Qiramarrësi e përdor sipas destinimit të caktuar, e mirëmban hapësirën, nuk bënë ndërhyrje pa leje, dhe paguan shpenzimet e tjera.
- 13.1.9 Ndërprerja e kontratës: Afati i njoftimit për qiramarrësin - 30 ditë; Ndërpreja e menjëhershme për shkelje të rënda, Procedura e dorëzimit të hapësirës;
- 13.1.10 Përgjegjësitë dhe dëmet materiale (dëmet duhet të konstatohen përmes procesverbalit të Komisionit përkatës)
- 13.1.11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, Juridiksioni (psh. Gjykata kompetente në Prishtinë)

Neni 14

Hapësirat për qiradhënie me sipërfaqe dhe çmime

- 14.1 Të gjitha hapësirat e destinuara për qiradhënie me sipërfaqe dhe çmim janë të përcaktuara sipas shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 15

Ndëshkimi

- 15.1 Moskthimi i hapësirës në gjendjen e mëparshme nga qiramarrësi pason me ndëshkim në vlerën e depozitit prej 300€.
- 15.2 Dispozitat e këtij neni zbatohen njësoj për kontratat afatgjata edhe për kontratat afatshkurtra.

Neni 16

Shtojcat e rregullores

- 16.1 **Shtojca 1**- Çmimet për shfrytëzimin e hapësirave afariste të cilat gjenden në pjesë të ndryshme të cilat i shfrytëzojnë persona të ndryshëm juridik dhe fizik, përcaktohen në bazë të kontratës, ku përfshihet çmimi për një (1) metër katror (m²), plus shpenzimet e përbashkëta si dhe TVSH 18% dhe tatimi i qirasë në burim 9%.
- 16.2 **Shtojca 2**- Harta e zonave të hapësirave për qiradhënie.

Neni 17
Hyrja në fuqi

17.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja paraprake me nr.1/883 dt 22.06.2023 dhe aneksi me nr. 1/1344 të datës 15.11.2024 për mënyrëndhe kushtet e shfrytëzimit të hapësirave kulturore, sportive dhe ekonomike.

17.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njëjtës procedure, sikurse për për nxjerrjen e kësaj Rregulloreje.

17.3. Kjo Rregullore miratohet dhe hyn në fuqi nga datë 1 Prill 2026.

K.M.A. PRISTINA

MIRATUAR NGA BORDI I DREJTOREVE:

Ariana Pireva – Kryesuese

Gani Sopi – Anëtar

Vjosa Rrahmani – Anëtare

Shuajb Mehmeti – Anëtar



SHTOJCA 1

Çmimet për shfrytëzimin e hapësirave afariste të cilat gjenden në pjesë të ndryshme (lokaleve afariste, zyrave, depove, shtandeve, etj) dhe të cilat i shfrytëzojnë persona të ndryshëm juridik dhe fizik, përcaktohen në bazë të kontratës, ku përfshihet çmimi për një (1) metër katror (m²), plus shpenzimet e përbashkëta si dhe TVSH 18% si dhe ndalja e tatimit në qira në burim (9%).

Çmimet e shërbimeve Kulturore	Çmimet
Aktivitetet kulturore dhe jo kulturore (orë) -Salla e Kuqe	120 €
Aktivitetet kulturore dhe jo kulturore (ditore) -Salla e Kuqe	1,000 €
Aktivitetet kulturore jo kulturore (ditore) -holli mes Sallës së Kuqe dhe Atelie Sallës ose Holli I Katit II	120 €
Aktivitetet kulturore dhe jo kulturore (orë) -holli mes Sallës së Kuqe dhe Atelie Sallës ose Holli i Katit II	50 €
Aktivitetet promovuese në Sallën e Kuqe (3 orë bllok, për çdo orë shtesë 120€)	300 €
Aktivitetet kulturore në hapësirat e Pallatit të Rinisë(ditë)	1,000 €
Çmimet e shërbimeve sportive	
Aktivitetet promovuese në Sallën e Vogël të Sportit (ditore)	2,500 €
Aktivitetet promovuese në hollin në mes Salles së Vogël të Sportit dhe Sallës Universale (ditore)	420 €
Aktivitetet promovuese në hollin në mes Sallës së Vogël të Sportit dhe Sallës Universale (orë)	120 €
Aktivitetet promovuese në Sallën së Vogël të Sportit (orë)	500 €
Çmimet e Shërbimeve në Sallën e Vogël: (Basketboll,Hendboll,Volejbol,Futsall,Boks,Karate, Xhudo dhe Gara Shkollore nga ora 06:00-18:00)	15 €
Çmimet e Shërbimeve në Sallën e Vogël (Basketboll,Hendboll,Volejbol,Futsall,Boks,Karate, Xhudo dhe Gara Shkollore nga ora 18:00-24:00)	20 €
Çmimet e Shërbimeve në Sallën e Vogël (për ndeshje Kombëtare/Ndërkombtare, pa publik)	150 €

Çmimet e Shërbimeve në Sallën e Vogël (për ndeshje Kombëtare/Ndërkombtare, me publik)	200 €
Çmimi i organizimeve të Turneve Kombëtare dhe Ndërkombetare (në të gjitha sportet/ ditore)	500 €
Çmimet e Shërbimeve në Sallat e Ushtrimeve (Sporteve Luftarake,Karatesë,Pingpongut,Gjymnastikes,Boksit, Peshëngritjes /për orë)	5 €
Çmimet e Shërbimeve për Aktivitete/Lojra (me publik dhe pa publik)	8 €
Çmimet e shfrytëzimit të Pllatos	
Dhënia në shfrytëzim e Pllatos (ditore)	1,200 €
Dhënia në shfrytëzim e Pllatos (orë)	500 €
Dhënia në shfrytëzim e Pllatos 1/2 (ditore)	600 €
Dhënia në shfrytëzim e Pllatos 1/2 (orë)	250 €
Dhënia në shfrytëzim e Pllatos në kuadër të Panaireve (për m2)	1.20 €
Dhënia në shfrytëzim e Pllatos për aktivitete të ndryshme 10 ditë e më shumë (per m2)	2 €
Shfrytëzimi i stendave me qira (brenda hapësirave të pallatit, per m2, përmes komisionit vlerësues)	10 €
Shfrytëzimi i stendave me qira (jashtë hapësirave të pallatit, për m2, përmes komisionit vlerësues)	24.36 €
Hapësira për vendosjen e bankomatave	
Sipas hapësirave që disponon ndërmarrja	400 €
Tarifa për xhirime të ndryshme në hapësira të pallatit	
Të gjitha kërkesat për xhirime të ndryshme në hapësira të ndryshme të pallatit 1-3h paguajnë shumën, (për çdo orë shtesë 30€)	100 €
Çmimi për parkingje	
Parkingu per nje veture te pjesa e salles universale	35 €
Parkingu per dy vetura te pjesa e salles universale	50 €

SHTOJCA 2
Harta e zonave të hapësirave për qiradhënie




Nr.	ZYRE	M2	Çmimi	Valuta
1	SU 001	11.96	10.89	€
2	SU 002	12.18	10.89	€
3	SU 003	12.18	10.89	€
4	SU 004	11.96	10.89	€
5	SU 005	25.2	10.89	€
6	SU 006	12.28	10.89	€
7	SU 007	12.18	10.89	€
8	SU 008	11.96	10.89	€
9	SU 035	59.97	15	€
10	SU 036	59.44	15	€
11	SU 040 - SU 055	361.64	5	€
12	SU093; SU094; SU095; SU096	143.14	5.99	€
13	SU 097	31.3	5.99	€
14	SU 097-1	36.51	5.99	€
15	SU 091	301.16	15	€
16	SU 100	513.28	15	€
17	PR 007	40.8	11.32	€
18	PR 010	48.1	10.78	€
19	PR 011	48.1	11.86	€
20	PR 012	63.9	10.78	€
21	PR 013	130.17	15	€
22	PR 014	63.9	15	€
23	PR-024	124.4	15	€
24	PR-025	15.99	15	€
25	PR-049	50.59	15	€
26	Pr-001,032,033,034,036,038,040	419.15	15	€

27	PR 066,067,068,069,070,071,072,073	815.02	15	€
28	PR 002,003,004,005,054	284.55	15	€
29	PR 027- 033, PR 069 - 076, PR 015- 016	750.9	15	€
30	PR-047,048	603.13	7.5	€
31	PR-016	251	15	€
32	PR 042,045,047-050,051-054, 058- 061	841.46	15	€
33	PR 010,063-068	277.12	15	€
Nr.	DEPO	M2	Çmimi	Valuta
1	SU 037	27.41	7.5	€
2	SU 038	58.2	7.5	€
3	SU 056	59.9	3.58	€
4	SU 057	56.69	3.58	€
5	SU 058	34.2	3.58	€
6	SU 059	64.67	3.58	€
7	SU 060	70.64	3.58	€
8	SU 061	69.82	3.58	€
9	SU 062	72.98	3.58	€
10	SU 063	72.86	3.58	€
11	SU 064	73.49	3.58	€
12	SU 065	68.07	3.58	€
13	SU 066	113.52	3.58	€
14	SU 073	13.9	7.5	€
15	SU 076	27.58	7.5	€
16	SU 077	50.69	3.58	€
17	SU 080	25.8	7.5	€
18	SU 082	50.33	3.58	€


 INSTITUTI
 e Auditimit
 Shtetëror
 RIŠTIT



19	SU 083	85.28	3.58	€
20	SU 084	39.32	3.58	€
21	SU 085	52.88	3.58	€
22	SU 086	27.41	7.5	€
23	SU 087	27.41	7.5	€
24	SU 088	24.34	7.5	€
25	PR 036	70.66	3.77	€
26	PR 037, 039	105.49	7.5	€
27	PR 055-057	95.25	7.5	€
Nr.	TERASA	M2	Çmimi	Valuta
1	QT 52/1	47.21	9.13	€
2	QT 53/1	47.21	9.13	€
3	QT 67/1	151.23	9.13	€
4	QT 67/2	151.23	9.13	€
5	PR 080/1	122	3.46	€
6	SU 011	47.1	9.13	€
Nr.	SALLE	M2	Çmimi	Valuta
1	PR 009	519.95	120€/ore	€
2	PR 021	619.69	120€/ore	€
3	SU 090	2277.91	5€ / ore	€
4	SU 101	305.78	5€ / ore	€
5	SU 102	238.37	5€ / ore	€
6	SU 103	218.83	5€ / ore	€
7	SU 104	192.87	5€ / ore	€
8	SU 105	235	5€ / ore	€
9	SU 108	107.62	5€ / ore	€
10	SU 109	75.35	5€ / ore	€
11	SU 099	108.56	7.5€ / ore	€



12	SU 107	426.61	7.5€ / ore	€
Nr.	PARKINGU I PALLATIT	M2	Çmimi	Valuta
1	SU 106/ PARKINGU	7863.99	35€/veture	€
			50€ / per dy vetura	€
2	PLLATOJA	8000	1.20/ m2	€
3	SU 112/ Palestra me tribuna	4645.23	43.41€/ ore	€

